



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:241017
Datë: 10.09.2024
Numri i dokumentit: 06141373

KE.nr. 397/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit “Call Home Electronics” Sh.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 70791730 dhe seli në Prishtinë, rr. “Isa Boletini”, nr. 59, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Kushtrim Bytyqi, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit “Raf II” Sh.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 70177148 dhe seli në Rahovec, rr. “Xhelal Hajda Toni”, p.nr., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Bajram Morina, avokat nga Gjakova, me objekt kontesti mos përmbushje e kontratës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 12.08.2024, në prezencë të autorizuarve të paditësit dhe të paditurit, me datë 10.09.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Call Home Electronics” Sh.P.K. me seli në Prishtinë ashtu që DETYROHET i padituri “Raf II” Sh.P.K., me seli në Rahovec, që në emër të mos përmbushjes së kontratës për instalimin e rrymës elektrike, ripërtërirjen e rrymës së instaluar dhe vazhdimin e punimeve elektrike të datës 21.04.2016, si dhe anekseve të datës 09.08.2016 dhe datës 20.12.2016, t’ia paguaj paditësit shumën prej 17,811.67 EUR, me kamatë ligjore prej 8% dhe atë duke filluar nga data e paraqitjes së padisë më 25.03.2019 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.
- II. OBLIGOHET i padituri, që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, t’ia paguaj paditësit shumën prej 1,968.00 EUR dhe atë në afat prej shtatë (7) ditësh, nga plotëfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

1. Çështja gjyqësore dhe pretendimet e palëve

Paditësi “Call Home Electronics” Sh.P.K., përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 27.03.2019 ka paraqitur padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike ndaj të paditurit “Raf II” Sh.P.K., për kompensimin e pjesës së pa përmbushur të kontratës për instalimin e rrymës elektrike të datës 21.04.2016 në vlerë prej 68,145.35 EUR.

Në referatin e padisë ka theksuar e paditura si porosites i punës, me anë të kontratës së datës 21.04.2016 kishte angazhuar paditësin për projektimin, furnizimin, montimin dhe rregullimin e rrymës në objektin e “Omnisport” në Mitrovicë, projekt ky për të cilin i padituri ishte përfitues nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, ashtu që vlera e kontratës sipas ofertës së paditësit është dakorduar në shumë prej 330.000.00 me TVSH. Ndërsa, me datë 09.08.2016, palët kanë nënshkruar aneks kontratën me të cilën kanë arritur marrëveshje që i gjithë materiali për realizimin e kontratës të importohet në emër të të paditurit pasi që i njëjti është i liruar nga taksa doganore dhe TVSH nisur nga fakti se i padituri ishte përfitues i projektit të Bashkimit Evropian, ashtu që vlera e kontratës pa TVSH arrinte në shumë prej 279,661.02 EUR. Kurse me datë 20.12.2016 kishin lidhur edhe një tjetër aneks kontratë me të cilën ishin përcaktuar punë shtesë në objekt në vlerë prej 5,000.00 EUR. Tutje, ka shtuar se pas realizimit të punimeve dhe pranimit të tyre nga ana e të paditurës pa asnjë vërejtje apo reklamim, i padituri nuk ka pranuar që të arrijnë marrëveshje me qëllim që të bëhet përlllogaritja finale e obligimit për pagesë. Prandaj paditësi, në bazë të përlllogaritjeve që ka bërë vet i ka lëshuar të paditurit faturën përfundimtare nga realizimi i kontratës dhe anekseve të saj, ashtu që vlerës totale të kontratës me TVSH në shumë prej 330.000.00 EUR i ka zbritur furnizimet e realizuara në emër të paditurit në shumë prej 101,696.60 EUR dhe faturat paraprake të lëshuara dhe të paguara nga i padituri në shumë prej 156,269.10 EUR, pas së cilave vlera e faturës përfundimtare është 68,146.35 EUR.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, përfaqësuesi i paditësit ka bërë zvogëlimin e lartësisë së kërkesëpadiisë dhe atë duke kërkuar vetëm shumën prej 17,811.67 EUR duke u bazuar në ekspertizën financiare të datës 29.11.2021 dhe plotësimin të saj të datës 22.04.2022, pasi që sipas paditësit, eksperti drejtë ka konstatuar se në kontratën e lidhur mes palëve ndërgjyqëse, TVSH-ja dhe ngarkesat Doganore duhet abstrahuar, meqenëse projekti në të cilin kanë pasur të kryhen punimet ka qenë i financuar nga Bashkimi Evropian dhe mbi këtë bazë importet e materialit kanë qenë të liruara nga taksa doganore dhe TVSH. Andaj, gjykatës i ka propozuar që t’ia fal besimin variantit të parë të ekspertizës të cilën e ka mbështetur edhe vet eksperti financiar, ashtu që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadiia e paditësit dhe të detyrohet i padituri që t’ia paguajë

paditësit shumën prej 17,811.67 EUR në emër të borxhit sipas kontratës së datës 21.04.2016 dhe anekseve të saj, me kamatë ligjore prej 8%, nga paraqitja e padisë me datë 19.02.2019 e deri në pagesën e plotë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe specifikuar.

I padituri, përmes përfaqësuesit të autorizuar, në përgjigje në padi ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar me arsyetimin se paditësi ka lëshuar tri fatura përfundimtare, përkatësisht Faturën nr. 02032019/CHE të datës 07.03.2019 në vlerë prej 68,146.35 EUR dhe dy fatura me numër të njëjtë 02012019 dhe me datë të njëjtë 17.01.2019, por me shuma të ndryshme 20,011.57 € dhe 29,427.61 €, ashtu që të njëjtat nuk prodhojnë efekt juridik pasi që nuk janë mbështetur në asnjë prove me të cilat paditësi do të arsyetonte kryerjen e punëve eventuale në interes të paditurës në lartësi të shumës së precizuar në padi – kërkesëpadi. Ka shtuar se i padituri ka përmbushur të gjitha detyrimet ndaj paditësit dhe palë e dëmtuar në marrëdhëniet e gjertanishme afariste sipas kontratës nuk është paditësi, por e paditura, bazuar në faktin se përfaqësuesit e Komisionit Evropian, në takimin e mbajtur me datën 11.12.2018 me përfaqësuesit e të paditurës, kanë dhënë vërejtje me shkrim për pajisjet, por megjithatë vërejtjet e dhëna nga Komisioni Evropian nuk janë eliminuar nga paditësi edhe pse paditësi sipas kontratës ka qenë i obliguar që t'i eliminoj vërejtjet brenda një afati optimal, duke u detyruar të paditurin që të caktojë një operator tjetër ekonomik për evitimin e të metave në punët e kryera nga paditësi.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, i padituri përmes përfaqësuesit të autorizuar ka qëndruar pranë përgjigjes në padi ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se me dispozitat e nenit 12 par. 2 të kontratës bazë të lidhur me datë 19.04.2016 dhe me dispozitat e paragrafit 2 të Aneksit të Kontratës të datës 09.08.2016, është përcaktuar se vlera e paguar për import plus vlera e Doganës dhe TVSH për të cilën është i liruar i padituri me rastin e importimit të materialeve elektrike, të zbritet në shumën totale të Kontratës (bazë) me TVSH, ndërsa pjesa tjetër faturohet pa TVSH sipas nenit 52, nen par. 1.4.1 dhe 1.4.2 të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Më tej ka theksuar se ekspertiza financiare, plotësimi i ekspertizës financiare, si dhe deklaratimet e ekspertit financiar në seanca janë ta pabazuara duke i propozuar gjykatës që të mos i'a fal besimin të njëjtave, pasi që nuk kanë vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, ku gabimisht dhe pa bazë ka konstatuar se obligimi përfundimtar është 17,811.67 EUR sipas variantit të parë dhe 9,843.08 EUR sipas variantit të dytë, pasi që përmes provave është vërtetuar se paditësi është ai që ka obligim ndaj të paditurit dhe atë në shumën prej 16,241.74 EUR. Gjykatës i ka propozuar që të refuzojë si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe

të detyrohet paditësi që të paditurës t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në emër të përpilimit të përgjigjes në padi në shumë prej 416.00 €, në emër të përpilimit të dy parashtrësive në shumë prej 416.00 €, në emër të përfaqësimit në pesë seanca në shumë prej 1,352.00 €, në shumën e përgjithshme prej 1,976.00 €, të gjitha në afat prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

2. Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore dhe në bazë të propozimeve të palëve ndërgjyqëse, gjykata gjatë procedurës së provave bëri administrimin e këtyre provave: Kontrata për instalimin e rrymës elektrike e datës 19.04.2016 së bashku me ofertën e punës, Aneksi i kontratës i datës 09.08.2016, së bashku me faqe tabele, Aneksi 2 i kontratës i datës 19.12.2016, Fatura nr. 01.2016/25 e datës 22.09.2016, Fatura nr. 7208 e datës 17.10.2016, Fatura nr. 6250 e datës 27.09.2016, Fatura nr. 002569 e datës 15.08.2016; Fatura nr. 007/16 e datës 29.06.2016, Fatura nr. 020/16 e datës 06.11.2016, Fatura nr. 028/16 e datës 27.12.2016, Fatura nr. 002/17 e datës 03.02.2017, si dhe 4 urdhërpagesa bankare për pagesën e këtyre faturave; Fatura nr. 02032019 e datës 07.03.2019, si dhe komunikimi elektronik për dorëzimin e kësaj fature 07.03.2019, Specifikacioni përfundimtar i përpiluar nga e paditura me datë 19.02.2019, së bashku me provat e bashkangjitura këtij specifikacioni, Vërejtja e datës 17.01.2019, Vërejtja e datës 06.04.2017, Vërejtja e datës 11.05.2017 përmes adresës elektronike, Referenca e datës e muajit maj 2017, Procesverbali mbi dëgjimin e dëshmitarëve Z.K. dhe E.B. e datës 10.09.2021, DUD nr. R-26117 i datës 26.09.2016, nr. R-45277 i datës 28.09.2016, R-10725 i datës 24.08.2016, R-49795 i datës 22.10.2016 së bashku me faturat dhe pagesat përcjellëse, Fatura nr. 02012019 e datës 17.01.2019, si dhe komunikimi elektronik i bashkangjitur, Fatura nr. 02012019 e datës 17.01.2019, në vlerën prej 29,427.61 si dhe komunikimi elektronik i bashkangjitur, Ekspertiza financiare e datës 29.11.2021, Plotësimi i ekspertizës financiare i datës 22.04.2022.

Gjykata pas vlerësimit të deklarimeve të palëve ndërgjyqëse, në kuptim të nenit 8 të LPK-së me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar për arsyt si në vijim:

Mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se të njëjtit kanë qenë në raport kontraktual sipas kontratës së datës 19.04.2016 ashtu që e paditura si porositës i punës dhe furnizimit, kishte angazhuar paditësin për projektimin, furnizimin, montimin dhe rregullimin e rrymës në objektin

e “Omnisport” në Mitrovicë e për të cilin projekt, i padituri ishte përfitues nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Ndërsa në ofertën e punës si aneks i kësaj kontrate, është përcaktuar çmimi i punimeve në vlerë prej 330,000.00 EUR me TVSH.

Po ashtu, mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se të njëjtit nuk kanë bërë barazimin përfundimtar financiar të obligimeve që i padituri si porositës ka pasur për paditësin si kryers i punimeve nga kontrata e datës 19.04.2016, por që kontestuese mes palëve ndërgjyqëse ishte fakti se a ka mbetur i padituri në obligim ndaj paditësit lidhur me punët e kryera sipas kësaj kontrate dhe anekseve të saj të daëts 09.08.2016 dhe datës 19.12.2016.

Nga provat tjera gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Nga aneksi i kontratës i datës 09.08.2016, gjykata vërtetoi faktin se palët ndërgjyqëse janë pajtuar që i gjithë materiali elektrik i cili importohet për qëllim të realizimit të kontratës së datës 19.04.2016, të importohet në emër të të paditurit “Raf II” Sh.P.K., kjo për faktin se duke qenë përfitues i projektit të financuar nga Bashkimi Evropian në Kosovë, i padituri lirohet nga Dogana dhe TVSH-ja me rastin e importimit. Sipas aneksit të kontratës, palët janë pajtuar që vlera e paguar për import, vlera e doganës dhe TVSH së liruar zbritet në shumën totale të kontratës me TVSH, ndërsa pjesa tjetër faturohet po ashtu pa TVSH. Kësisoj palët kanë sqaruar se vlera e gjithmbarshme e kontratës është 279,661.02 EUR.

Nga Aneksi 2 i kontratës i datës 19.12.2016 palët janë pajtuar që paditësi, të kryej punë shtesë për të paditurën dhe atë automatizimin, aftësimin, instalimin dhe lëshimin në punë të komandimit të nxehtësisë, ventilimit dhe të gjitha komandimet automatike në objektin OMNI në Mitrovicë, ndërsa me nenin 5 të kontratës, kanë përcaktuar çmimin e këtyre punimeve në vlerë prej 5,000.00 EUR.

Nga Referenca e muajit Maj 2017 gjykata konstatoi se i padituri, ka lëshuar për paditësen një referencë duke theksuar se paditësja ka treguar profesionalizëm të lartë në ekzekutimin e projektit për Qendrën Sportive OMNI Sport në Mitrovicë.

Nga vërejtja e datës 06.04.2017, gjykata konstatoi se paditësi i është drejtuar të paditëses duke i kërkuar që t’i dërgoj listën e vërejtjeve për elektrinë, ndërsa nga komunikimi elektronik i datës 11.05.2017, e paditura e ka njoftuar paditësen me listën e vërejtjeve të dhëna nga inxhinieri i mbikëqyrjes së vend punimeve dhe inxhinieri i të paditurës.

Nga Fatura nr. 02012019 e datës 17.01.2019, gjykata konstatoi se paditësja, në emër të barazimit përfundimtar sipas kontratës së datës 19.04.2016 dhe aneks kontratës së datës 09.08.2016 dhe aneksit të datës 19.12.2016, kishte faturuar të paditurin me vlerën totale prej 20,011.57 EUR, të cilën faturë kishte dërguar tek e paditura përmes adresës elektronike me datë 17.01.2019.

Nga Fatura nr. 02012019 e datës 17.01.2019 gjykata konstatoi se paditësja, në emër të barazimit përfundimtar sipas kontratës së datës 19.04.2016 dhe aneks kontratës së datës 09.08.2016 dhe aneksit të datës 19.12.2016, kishte faturuar të paditurin me vlerën totale prej 29,427.61 EUR, të cilën faturë kishte dërguar tek e paditura përmes adresës elektronike me datë 05.02.2019.

Nga Fatura nr. 02032019 e datës 07.03.2019 gjykata konstatoi se paditësja, në emër të barazimit përfundimtar sipas kontratës së datës 19.04.2016 dhe aneks kontratës së datës 09.08.2016 dhe aneksit të datës 19.12.2016, kishte faturuar të paditurin me vlerën totale prej 68,146.35 EUR, të cilën faturë kishte dërguar tek e paditura përmes adresës elektronike.

Nga specifikacioni përfundimtar i përpiluar nga e paditura me datë 19.02.2019, së bashku me provat e bashkangjitura këtij specifikacioni, konstatohet se e paditura ka ardhur në përfundim se shuma e pagesave të kryera nga i padituri për paditësin arrin vlerën prej 325.206.06 EUR.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 10.09.2021, është bërë dëgjimi i pronari i paditëses Z.K. i cili ka deklaruar se me të paditurën fillimisht ka pasur tentime për zgjidhjen e kontestit me marrëveshje jashtë gjyqësore, por që ky tentim ka qenë i pa suksesshëm. Ka shtuar se pas përfundimit të punimeve sipas kontratës në muajin maj 2017, paditësi ka pranuar nga e padituri referencën me punët e kryera dhe se paditësi asnjëherë nuk ka pranuar asnjë vërejtje për punët e kryera apo ndalesë të punimeve. Ka sqaruar se me datë 06.04.2017, ka pranuar një email nga e paditura lidhur me listën e defekteve të punimeve, të cilat vërejtje paditësi i ka eliminuar brenda tre-katër ditëve nga dërgimi i vërejtjes. Ka sqaruar se fatura e fundit në vlerë prej 68,146.36 EUR e lëshuar me datë 07.03.2019 paraqet vlerën e punëve përfundimtare të papaguara nga i padituri. Ka deklaruar më tej se punimet janë konsideruar të kryera në muajin maj 2017 pas marrjes së vërejtjeve nga e paditura dhe eliminimit të tyre nga paditësi, ndërsa garancioni për punët e kryera sipas kontratës ka qenë një (1) vit.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 10.09.2021, është bërë dëgjimi i pronari i të paditurës në cilësi të dëshmitarit E.B., cili ka deklaruar se i padituri i ka përmbushur të gjitha obligimet financiare tek paditësi në vlerë prej 325.206.06 EUR ndërsa pranimi final nuk është bërë gjatë periudhës 1 vjeçare të garancionit për faktin se autoriteti kontraktues ka gjetur vërejtje në

pozicionet e punëve të kryera, ndërsa paditësja në vend që të bëj përmirësimin e punimeve, e njëjta ka kushtëzuar eliminimin e vërejtjeve vetëm pas pagesës së faturë përfundimtare, të cilën fillimisht e ka lëshuar në shumë prej 20,011.57 EUR, e pastaj 29.427.61 EUR, dhe me email-in e datës 07.03.2019 ka kërkuar që në emër të barazimit të punimeve të paguhet shuma prej 68,146.35 EUR. Ka shtuar se këtë barazim i padituri nuk e ka pranuar pasi që ka qenë i i përpiluar komplet njëanshëm nga paditësi e për më tepër i padituri fare nuk i ka ngelur borxh paditësit. Tutje ka sqaruar se nuk ka njohuri se kush e ka lëshuar referencën e muajit maj 2017 për paditësen, pasi që përkundër se vula në këtë referencë është e kompanisë, në këtë dokument nuk përmbahet nënshkrimi i pronarit të paditësit.

Me qëllim të vërtetimit të lartësisë së kërkesëpadisë, konkretisht faktit se sa është shuma e mbetur e papaguar nga i padituri për paditësin sipas kontratës së datës 21.04.2016 së bashku me anekset e saj, gjykata, sipas propozimit të palës paditëse, ka aprovuar marrjen e provës me ekspertizë nga lëmia financiare.

Eksperti financiar R.S., në ekspertizën e përpiluar me datë 29.11.2021 ka konstatuar se palët kontraktuese, në kontratën e lidhur kanë përcaktuar çmimin total në vlerë prej 330.000.00 duke përfshirë edhe TVSH-në, por meqenëse i padituri “Raf II” Sh.P.K., paraqitet si kontraktor i Zyrës së Bashkimit Evropian, për të cilën edhe është dashur të ekzekutohen punimet, atëherë kontraktuesi i dytë, këtu paditësi, është dashur që ta faturoj të paditurin me ngarkesë të kundërt, që do të thotë pa TVSH, kjo meqenëse i padituri ka qenë i liruar nga TVSH-ja dhe Dogana. Në këtë situatë, eksperti ka përcaktuar se çmimi i kontratës pa TVSH kap vlerën prej 279,661.02 EUR prej të cilës, i padituri ka paguar vlerën prej 162.796.12 EUR, si dhe ka blerë mall në vlerë prej 101,553.23 EUR, ashtu që borxhi total i pa paguar për paditësin kap vlerën prej 15,311.67 EUR, shtu ktu edhe borxhin për aneksin e dytë të kontratës në shumën prej 2,500.00 EUR, pra në total vlera prej 17,811.67 EUR.

Në plotësimin e ekspertizës financiare të datës 22.04.2022, eksperti financiar, duke vepruar sipas detyrave shtesë të gjykatës, ka hartuar dy variante të ekspertizës financiare sa i përket borxhit eventual të papaguar nga i padituri për paditësin. Në variantin e parë, të cilin eksperti financiar e ka mbështetur, ka ri theksuar se kontrata mes palëve ndërgjyqëse është dashur ta përfshij çmimin pa TVSH, meqenëse i padituri “Raf II” Sh.P.K., ka qenë i liruar nga TVSH-ja dhe Dogana, dhe se i njëjti nuk ka mundur që të kërkoj nga paditësi që vlera e liruar e TVSH-së dhe Doganës ti llogaritet si vlerë e paguar në emër të punimeve të kryera, kjo përderisa i padituri asnjëherë nuk e ka paguar TVSH-në dhe Doganën, meqenëse ka qenë i liruar. Andaj mbi këtë

për llogaritje, ka konstatuar se borxhi i papaguar nga i padituri për paditësin kap vlerën prej 17,811.67 EUR. Ndërsa ka sqaruar se varianti i dytë, paraqet përlllogaritjen e borxhit që i padituri ka për paditësin sikurse çmimi i kontratës mes palëve të trajtohej duke e përfshirë TVSH-në, pra në situatën kur vlera e TVSH-së dhe Doganës për të cilën i padituri ka qenë i liruar me rastin e importimit të materialeve elektrike, të llogaritej si vlerë e paguar për paditësin në emër të punimeve të kryera, ashtu që në këtë situatë, borxhi i mbetur i të paditurit për paditësin do të ishte në shumën prej 9,843.08 EUR. Ka theksuar se meqenëse kemi të bëjmë me çështje ligjore, i mbetet gjykatës që të vendos se cilin variant të ekspertizës do ta marrë për bazë.

Në sqarimet e dhëna në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 12.08.2024, eksperti ka sqaruar se qëndron pas variantit të parë të ekspertizës, ku në rastin konkret, të gjitha faturimet nga paditësi për të paditurin është dashur të lëshohen me ngarkesë të kundërt pra pa TVSH, kjo meqenëse i padituri është i liruar nga TVSH-ja, ashtu që borxhi i ngelur i mbetur i papaguar nga 17,811.67 EUR

3. Vlerësimi përfundimtar i Gjykatës

Në rastin konkret, nga vlerësimi i gjithmbarshëm i provave të administruara dhe nga gjendja faktike e vërtetuar, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e dëmit për shkak të mos përmbushjes së plotë të kontratës ndaj të paditurit është e bazuar.

Deri tek ky vlerësim gjykata erdhi pasi nga kontrata e datës 19.04.2016 për kryerjen e punimeve të instalimit të rrymës elektrike, gjykata vërtetoi faktin se palët ndërgjyqëse, kanë hyrë në një raport juridik kontraktual ku i padituri ka pasur cilësinë e porositësit të punëve, ndërsa i padituri ka pasur cilësinë e kryerësit të punimeve, ndërsa çmimi i punimeve ishte përcaktuar në vlerë prej 330.000.00 EUR përfshirë TVSH-në. Tutje, nga aneksi i parë i kontratës i datës 09.08.2016, gjykata vërtetoi faktin se palët janë pajtuar që i gjithë materiali elektrik që është dashur të porositet dhe të instalohet nga paditësi, të importohet në emër të të paditurit, kjo meqenëse ky i fundit lirohet nga ngarkesat doganore dhe TVSH-ja në mallrat e importuara meqenëse ka cilësinë e përfituesit të projektit të financuar nga Bashkimi Evropian në Kosovë, andaj të njëjtit kanë konstatuar se vlera e gjithmbarshme e kontratës pa aplikimin e TVSH-së është 279,661.02 EUR.

Ndërsa, nga ekspertiza financiare e punuar nga eksperti Vehbi Smajli me datë 29.11.2021 dhe e plotësuar me datë 22.04.2022, gjykata vërtetoi faktin se nga çmimi i përgjithshëm mes palëve ndërgjyqëse sipas aneksit të parë të kontratës prej 279.661.02 EUR pa TVSH, i padituri ka bërë

pagesa në vlerë prej 162,796.12 EUR dhe ka importuar material elektrik në vlerë prej 101,553.23 EUR, apo në total shumë prej 264.349.35 EUR ashtu që shuma e mbetur e papaguar kap vlerën prej 15,311.67 EUR. Ndërsa, në seancën e datës 12.08.2024, pas sqarimeve të ekspertit dhe deklarimeve të palëve ndërgjyqëse, nuk ishte kontestues fakti se vlera prej 5,000.00 EUR e kontraktuar sipas aneksit II të datës 19.12.2016 kishte të bëjë me kontratën bazë të lidhur mes palëve ndërgjyqëse, e prej të cilës shumë, i padituri ka paguar vlerën prej 2,500.00 EUR, ashtu që shuma e mbetur e papaguar është në vlerë prej 2,500.00 EUR.

Nga këto të gjetura, gjykata erdhi në përfundim se shuma e pa përmbushur nga i padituri për paditësin sipas çmimit të kontratës së palëve ndërgjyqëse të lidhur me datë 09.08.2016, kontratë kjo e plotësuar me aneksin e datës 09.08.2016 dhe aneksin e dytë të datës 20.12.2016 arrin në vlerë prej 17,811.67 EUR (15,331.67+2,500.00), borxh ky i cili nuk është paguar nga i padituri.

Andaj, meqenëse i padituri ka vepruar në kundërshtim me kontratën e lidhur me paditësin, e kështu edhe në kundërshtim me nenin 8 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 2012 (LMD) i cili përcakton se *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”*, gjykata, në mbështetje të nenit 245 të LMD-së i cili parasheh se *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata pati parasysh pretendimet e të paditurit se në rastin konkret, vlera e ngarkesës Doganore dhe TVSH-së në për të cilën është liruar i padituri me rastin e importimit të materialeve elektrike, duhet zbritur në obligimin që i padituri ka pasur tek paditësi, pasi që kështu edhe palët janë dakorduar përmes aneks kontratës së datës 09.08.2016, por që këtë pretendim gjykata e vlerësoi si të paqëndrueshëm. Deri tek ky vlerësim gjykata erdhi duke iu referuar nenit 30 par 2., nën par 2.1 të Ligjit Nr. 05/L -037 për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar, nenit 30 par 2., nën par 2.1 i cili përcakton se *“Lidhur me mallrat e importuara dhe lëshimin e tyre në qarkullim të lirë, në pajtueshmëri me kushtet dhe afatet kohore të caktuara në legjislacionin doganor në fuqi, nga TVSH-ja, duhet të lirohen si në vijim; Lirime të veçanta: 2.1. importet e mallrave të financuara nga të ardhurat e donacioneve të bëra për buxhetin ose nëpërmes buxhetit të Kosovës ose nën mbikëqyrjen e organeve kompetente ose të financuara direkt nga kontratat për përfitim të Ministrive, autoriteteve lokale dhe organeve tjera të rregulluara me ligj, nga organizatat*

ndërkombëtare ndër-qeveritare dhe agjencitë e tyre, qeveritë, agjencitë qeveritare, organizata qeveritare dhe jo-qeveritare në mbështetje të programeve humanitare dhe të rindërtimit dhe projekteve të tjera, përfshirë projektet e Integrimeve Evropiane në Kosovë”.

Në mbështetje të rregullimit ligjor të lartcekur, rezulton se të paditurit nuk i takon e drejta që shumën e liruar të ngarkesave doganore dhe TVSH-së me rastin e importimit të materialeve elektrike ta zbres nga vlera e përgjithshme e obligimeve që ka ndaj paditësit si kryerës i punëve kjo për faktin se i padituri, nuk është ngarkuar me asnjë obligim doganor dhe as me TVSH me rastin e faturimit nga paditësi, kjo sepse ka qenë përfitues i projektit të financuar nga Bashkimi Evropian dhe ka qenë i liruar nga ngarkesat doganore.

Kësisoj, i padituri nuk ka mundur të përfitoj dyfish ashtu që në njërën anë të lirohet nga pagesa e ngarkesave Doganore dhe TVSH-së e në anën tjetër, këtë vlerë të liruar, ta kërkoj që t'i llogaritet si pagesë ndaj paditësit për punët e kryera me rastin e zbatimit të kontratës për instalimin e materialeve elektrike. Për më tepër, edhe sikur i padituri eventualisht do obligohej në pagimin e TVSH-së për mallrat e importuara të cilat veçse kanë qenë të lira nga TVSH-ja, nga deklaratimet e ekspertit financiar të dhëna në seancën e datës 12.08.2024 është sqaruar mjaftueshëm se edhe në këtë situatë, të paditurit do t'i ipej mundësia e kreditimit të TVSH-së, ashtu që i padituri këtë vlerë do mund ta shfrytëzonte për transaksione tjera duke e rimbursuar si TVSH të zbritshme, por në asnjë rrethanë nuk i mundësohet të paditurit që këtë vlerë ta kërkoj që ta rimbursoj tek pala paditëse.

Si rezultat i kësaj, gjykata nuk e morri për bazë variantin e dytë të hartuar nga eksperti financiar R.S. në plotësimin e ekspertizës së datës 22.04.2022, në të cilin variant ka konstatuar se në rast se vlera e TVSH-së dhe ngarkesave Doganore për të cilat është liruar i padituri do të zbritet në obligimin që i padituri ka për paditësin, vlera e borxhit do të mbetet në shumë prej 9,843.08 EUR por ia fali besimin vetëm sa i përket konstatimeve të dhëna në versionin e parë të ekspertizës, në të cilën është sqaruar se në rastin konkret, të paditurit nuk i takon që të përfitoj prej vlerës së ngarkesave doganore dhe TVSH-së së liruar, dhe të kërkoj që kjo vlerë të zbritet nga çmimi i përgjithshëm i kontratës, meqenëse i padituri si konsumator i fundit nuk ka qenë i ngarkuar me këto obligime dhe të njejtat nuk i ka paguar.

Pretendimet e të paditurit se paditësi ka bërë lëshime me rastin e kryerjes së punimeve për instalimin e pajisjeve elektrike, për të cilat lëshime është njoftuar me kohë por që nuk i ka

përmirësuar, gjykata i vlerësoi si të paqëndrueshme pasi që nga referenca e lëshuar nga vet i padituri në muajin maj 2017, vërtetohet se i padituri ka pranuar në tërësi punimet e kryera nga pala paditëse pa asnjë vërejtje apo kundërshtim. Për më tepër, i padituri, në asnjë fazë të procedurës nuk ka paraqitur kundër padi për të kërkuar kompensimin e dëmit për shkak të të metave eventuale në punimet e kryera nga paditësi andaj, pretendimet për të meta në kryerjen e punimeve nuk mund të mirren si shkak për zvogëlimin apo shuarjen e detyrimeve që i padituri ka për paditësin përderisa nuk ka kërkesë të veçantë nga i padituri për kompensimin e kërkesave me palën paditëse.

Gjykata pati parasysh edhe provat e nga i padituri dhe atë faturën nr. 007/16 të datës 29.06.2016, faturën nr. 020/16 të datës 06.11.2016, faturën nr. 028/16 të datës 27.12.2016, dhe faturën nr. 002/17 e datës 03.02.2017, si dhe 4 urdhërpagesat bankare për pagesën e këtyre faturave, por meqenëse këto fatura janë marrë për bazë nga eksperti financiar me rastin e hartimit të ekspertizës dhe shuma e paguar sipas këtyre faturave është zbritur në borxhin përfundimtar, gjykata nuk e pa të arsyeshme elaborimin e mëtejshëm të tyre.

Gjykata morri për bazë edhe provat tjera të administruara në këtë shqyrtim gjyqësor, por gjeti se të njëjtat nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe si nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.

Vendimin lidhur me lartësinë e kamatës ligjore dhe afatit të rrjedhjes së saj, gjykata e mbështeti në nenin 382 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së në ndërlidhje me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve të datës 18.03.2017. Në rastin konkret, shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së precizuar si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë: a) në emër të përpilimit të padisë vlerën prej 208.00 EUR, në emër të shpenzimeve për ekspertizë financiare shumën prej 350.00 EUR, në emër të përfaqësimit në pesë (5) seanca gjyqësore shumën prej 1,350.00 EUR (5x270), në emër të taksës gjyqësore për padi shumën prej 60.00 EUR, apo në total shumën e përgjithshme prej 1,968.00 EUR.

Nga të cekurat më lartë, gjykata bazuar në nenin 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 397/22, datë 10.09.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të Aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.